

# TOALETET PUBLIKE

## QYTETET GJITHËPËRFSHIRËSE

promovimi dhe përhapja e metodologjisë së  
planifikimit urban me pjesëmarrje



Ky hulumtim/produkt u realizua në kuadër të projektit "Qytetet Gjithëpërfshirëse" - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje" përkrahët financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahët nga Qeveria e Suedisë.

Përmbajtja është përgjegjësi e EC Ma Ndryshe dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e Olof Palme International Center



"Qytetet Gjithëpërfshirëse" - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje

# TOALETET PUBLIKE

dizajnimi i toaleteve publike për  
Qendrën Historike të Prizrenit

botues: EC Ma Ndryshe

autore: Flaka Xërxa Beqiri

asistente: Feray Dervis

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren  
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
029-222-771 & 038-224-967

Prizreni gëzon epitetin e qytetit të dytë në rradhë për nga numri i popullsisë. Për më tepër konsiderohet "kryeqytet kulturor" për nga numri i monumenteve historike dhe ngjarjeve kulturore. Ky fakt shton frekuencën ditore të kalimtarëve në këtë qytet, sidomos në qendrën historike. Qendra historike e Prizrenit edhe pse shumë e pasur me aktivitete ditore, të përhershme dhe mobile, një numër të konsiderueshëm të hapësirave publike, shesheve të frekuentuara dhe monumenteve historike dhe fetare, ende nuk ka hapësirë të dedikuar për toaleta publike. Në rradhën e shërbimeve publike në Prizren, ende nuk ofrohet shërbimi i toaleteve publike, dhe si rrjedhojë qytetarët kalimtarë të qendrës historike, e sidomos turistët, duhet të gjejnë alternativa të tjera për kryerjen e nevojave fiziologjike.

Si rrjedhojë e mungësës së një shërbimi bazik siç është komponentja e toaleteve publike, qytetarët të cilët shfrytëzojnë qendrën historike ndikohen në shfrytëzim të limituar të saj. Hapësirat publike nuk ofrojnë komoditet në shfrytëzim si rezultat i mungësës së toaleteve publike në afërsi. Rëndom qytetarët të cilët kanë zgjedhur hapësirat

publike për të kaluar momente të ditës së tyre, duhet të shpejtojnë për në kafenetë në afërsi në momentin që u nevojitet shfrytëzimi i toaletit. E njëjta aplikohet edhe te turistët që frekuentojnë monumentet historike apo pjesëmarrësit e festivaleve të ndryshme që ndodhin përgjatë kalendarit kulturor në Qendrën Historike të Prizrenit.

Mungesa e toaleteve publike ka ndikuar direkt edhe në cilësinë e higjienës në hapësirat publike. Në mungesë të tyre, rastet kur qytetarët shfrytëzojnë hapësirat publike për të kryer nevojat fiziologjike nuk janë të pakta.



Mungesa e toaleteve publike ka dalë të jetë shqetësim i qytetarëve të Prizrenit. Përgjatë hulumtimeve dhe punëtorive me grupet e ndryshme të komunitetit, del se mungesa e hapësirave të dedikuara për toaleta publike rrezulton të ndikojë drejtpërdrejt në përditshmërinë e tyre ("Planifikim urban për qytetarët 5", 2017 & "Gruaja dhe Hapesirat Publike", 2017). Bazuar në këto fakte, EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Qyteti Gjithëpërfshirës - lagje aktive për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren", përkrahur nga Olof Palme International Center, ka organizuar punëtorinë vizionuese "Dizajnimi i toaleteve publike nën Urën Arasta".

Punëtorja ka patur për fokus dhënjen e propozimeve konkrete rreth vizionimit për toaletet publike. Fillimisht pjesëmarrësit e punëtorisë të përbërë nga qytetarë, përfaqësues të organizatave kulturore, bizneseve lokale si dhe zyrtarë të organizmave të shërbimeve publike, kanë parafrazuar rëndësinë e intervenimit sa më të shpejtë për të patur minimalisht një hapësirë për toaleta publike në Qendrën Historike të Prizrenit. Veç tjerash, janë identifikuar edhe zonat e tjera në të cilat bazuar nga frekuentimi ditor i qytetarëve, është e rëndësishme dizajnimi i toaleteve publike.

Pjesëmarrësit janë fokusuar në shqyrtimin e mundësisë së ri-funksionalizimit të toaleteve publike nën urën Arasta, si një mundësi për intervenim më të shpejtë dhe me kosto më të ulët. Një intervenim i tillë do të ndihmonte në zgjidhjen e problemit për kohësisht. Ndërsa pas ri-vitalizimit të hapësirës së Kejit, lokacioni i toaleteve publike do të mund të ri-definohej.



Gjatë punëtorisë dy ditore është arritur koncepti për vizonimin e toaleteve publike. Pjesëmarrësit kanë konsideruar se gjithëpërfshirja është njëri nga faktor kryesor që duhet të mirret parasysh gjatë procesit të dizajnit të toaleteve publike për Qendrën Historike të Prizrenit. Në këtë mënyrë është propozuar që përveç nyjeve sanitare të ndara në gjini, grupacioni i toaleteve publike të ketë domosdoshmërisht një kabinë për personat me aftësi të kufizuara fizike, konkretisht shfrytëzuesve të karrocës invalide.


Pjesëmarrësit kanë diskutuar edhe komponenten gjinore në fazën e konceptualizimit të toaleteve publike, duke determinuar që të jetë një hyrje e vetme e cila më pas do të dërgonte në kabinat e ndara për të dy gjinitë.

Gjatë punëtorisë është diskutuar edhe për mundësinë e komplementimit të toaleteve publike me dy përmbajtje shtesë, atë të hapësirës për pastrimin e foshnjeve dhe hapësirën për gjidhënje.

Pjesëmarrësit në punëtori kanë ngritur qështjen e mungesës së këtyre dy përmbajtjeve në kuadër të hapësirave publike, duke ndikuar drejtpërdrejt në kualitetin e shfrytëzimit të tyre nga prindërit me fëmijë të vegjël dhe nga nënat e reja.

REKOMANDIMET NGA PUNËTORIA





LUMI "LUMBARDHI"

URA "ARASTA"

TOALETET PUBLIKE



Propozimet e dalura nga puna direkte me pjesëmarrësit e punëtorive janë sinkronizuar me udhëzues ndërkombët arë të dizajnit të toaleteve publike. Urgjenca për implementimin e toaleteve publike nga të pranishmit e punëtorisë është plotësuar me kërkesën për dizajn gjithëpërfshirës, me normativa ndërkombëtare, dhe mirëmbajtje adekuate pas finalizimit të tyre.

Bazuar në manualin "A Guide to Better Public Toilet Design and Maintenance" (Restroom Association, Singapore, 2013), mungesa e toaleteve publike ndikon direkt në mirëqenjen dhe shëndetin publik të qytetarëve, duke rritur mundësinë e përhapjes së sëmundjeve të transmetueshme. Planifikimi i toaleteve publike në nivel të qytetit, në zonat me densitet të lartë dhe të mesëm të shfrytëzueshmërisë, është i domosdoshëm.

Rëndësia e funksionimit mirë të toaleteve ndikohet nga faza e dizajnit dhe ajo e mirëmbajtjes pas implementimit. Sipas këtij manuali definicioni i një "toaleti mirë të dizajnuar" nënkupton toalete:

1. Funksionalisht të përshtatshme
2. Të pastërta dhe pa lagështi
3. Mirë të ventiluara
4. Lehtë për tu mirëmbajtur
5. Të çashme për personat me aftësi të kufizuara

Meqenëse toaletet publike hyjnë në rradhën e hapësirave të cilat janë shumë të ndijshme duke marrë parasysh se ato shfrytëzohen nga pesona të panjohur, dizajni i tyre është mjaft kompleks dhe me shumë përgjegjësi. Aspekti gjinor, ai i shfrytëzimit nga pesona me nevojë të veçanta dhe kushtet higjienike, përbëjnë disa nga parametrat kryesorë gjatë fazës së dizajnit. Në mënyrë që një toalet publik të rrezultojë i shfrytëzueshëm, rekomandohet që gjatë fazës së dizajnit t'i kushtohet rëndësi: hyrjes në grupacionin e kabinave të ndara në gjini, shtrirjes funksionale të kabinave dhe të ndërlidhjes së tyre me komunikatën e përbashkët (korridoret), përfshirjes së kabinave të shfrytëzuara edhe/vetëm për persona me aftësi të kufizuara, dimensionimit të elementeve të nyjeve sanitare edhe për fëmijë, ndriqimit të përgjithshëm, materialeve të aplikuara, ventilimit adekuat, instalimeve të duhura të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe komponenteve të tjera të rëndësishme, varësisht nga lokacioni.

Pas fazës së implementimit të dizajnit të toaleteve publike, komponentë shumë e rëndësishme është procesi i mirëmbajtjes. Pastrimi ditor i shpërndarë në intervale të ndryshme kohore, ndihmon procesin e mbajtjes së pastërtisë në nivel dhe eliminimin e mundësisë së transmetimit të infeksioneve eventuale.

**NDRIÇIMI** - Përbën një prej komponenteve kryesore në funksionimin adekuat të toaleteve publike. Ato toalete të cilat nuk janë mirë të ndriçuara krijojnë përshtypjen e hapësirave jo mirë të pastruara dhe të pasigurta për shfrytëzim. Toaletet publike rekomandohet të ndriçohen me dritë të ngrohtë (jo të bardhë), në mënyrë që të krijohet ambient më i përshtatshëm për shrytëzim.

**MATERIALET** - Materialet e aplikuara në toalete publike rekomandohet të jenë të qëndrueshme dhe që pastrohen lehtë. Përzgjedhja e materialeve redukton nevojën për intervenime të mëvonshme. Gjatë përzgjedhjes së materialeve të mureve, dyshemesë dhe pllafonit, është shumë e rëndësishme që të mirret parasysh edhe paleta e ngjyrave të aplikuara, duke e ditur se ngjyrat e përzgjedhura mund të ndikojnë në rritjen apo zvogëlimin e ndriçimit të përgjithshëm.

**ELEMENTET E SANITARISË** - Të gjitha elementet e sanitarisë (guacat dhe pisoaret) të përzgjedhura për aplikim në toaletet publike duhet të funksionojnë në sistemin "fontanë", në mënyrë që pastërtia të jetë në nivel në kontinuitet. Rekomandohet që funksionimi i "fontanës" të jetë në mënyrë elektronike, në mënyrë që të funksionojë pamvarsisht kujdesit të treguar nga shfrytëzuesi. Lavamanët poashtu duhet të jenë kujdesshëm të dizajnuar, veçanërisht sa i takon shpërndarjes së piklave të ujit në afërsinë e shfrytëzuesit. Të gjitha elementet e sanitarisë duhet të jenë të dizajnuara në atë princip që të minimizojnë apo abstrahojnë nevojën e kontaktit me duar nga ana e shfrytëzuesit. Kjo për të reduktuar transmetimin e infeksioneve.

Në rastet e dizajnit të kabinave për personat me aftësi të kufizuara, elementet e sanitarisë aplikohen të veçanta, në bazë të normativave për shfrytëzim nga ana e PAK

**ELEMENTET PËRCJELLËSE** - Materiali higjienik nga letra rrezulton të jetë më i rekomanduari në kabinat e toaleteve publike. Poashtu në afërsi të guacave rekomandohet vendosja e mbulesave të guacave prej letre të cilat reduktojnë transmetimin e infeksioneve. Shportat për mbledhjen e mbeturinave rekomandohet të jenë të fiksuara në murë dhe me çasje nga personi përgjegjës për mirëmbajtje. Në afërsi të lavamanëve rekomandohet vendosja e tharëseve elektronike për duar, të cilat konsiderohen më ekologjike dhe më të përshtatshme për mirëmbajtjen. Me qëllim të aromatizimit konstant, rekomandohet vendosja e elementeve për shpërndarjen e aromave të ndryshme.

Bazuar në rekomandimet e dalura nga punëtorja dy ditore dhe në praktikat e mira të dizajnit të toaleteve publike, është dhënë propozimi konceptuel i ri-dizajnit të toaleteve publike nën Urën "Arasta". Ky lokacion precizohet të shfrytëzohet deri në momentin e ri-vitalizimit të Kejtit përgjatë "Lumbardhit".

Toaletet ekzistuese nuk përbushin as edhe për së afërmi parametrat elementar të toaleteve publike. Përveç tjerash ato nuk janë të çasshme për personat me aftësi të kufizuara, rrjedhimisht nuk mund të shfrytëzohen nga ky grup i komunitetit.


Kabinat ekzistuese nuk janë të ndara në gjini dhe mungojnë elementet sanitare adekuate, përfshirë këtu pisoaret. Lavamanët nuk përbushin kriteret e toaleteve publike, duke qenë se janë individuale. Materialet e aplikuara pamundësojnë mirëmbajtjen e toaleteve publike, marrë parasysh që nuk hyjn në kategorinë e materialeve që lehtësisht pastrohen. Ndriçimi është i dobët.

Si rezultat i këtyre parametrave dhe bazuar në faktin që nuk është siguruar ndonjë formulë adekuate sa i takon mirëmbajtjes, toaletet publike ekzistuese kanë rrezultuar jo-funksionale, tashmë për një periudhë.

Vizionimi i toaleteve publike nën Urën "Arasta" konsiston në propozimin e një zgjidhjeje të re funksionale, e cila ofron çasje dhe funksionalitet maksimal për të gjitha grupet e komunitetit. Lokacioni mbetet i njëjtë me toaletet ekzistuese ndërsa për shkak të rrijtes së funksionalitetit është bërë mbyllja e njërës hyrje, duke lënë hyrje nga vetëm njëra anë. Kjo është bërë për faktin që nga pjesëmarrësit e punëtorisë, veçanërisht përfaqësuesit e institucioneve që lidhen direkt me shërbimet publike në Prizren, është rekomanduar që toaletet publike të kenë vetëm një hyrje me qëllim të kontrollës më të lehtë të hyrje-daljeve dhe reduktimit të numrit të stafit mirëmbajtës. Ky intervenim, në mbylljen e njërës hyrje, ka rrezultuar pozitivisht edhe në insertimin e një kabine për shfrytëzim nga ana e personave me aftësi të kufizuara, e cila më parë për shkak të dimensioneve të kufizuara nuk është arritur të përfshihet.

Në mënyrë që të vërehet hyrja, dimensionin gjatësorë i toaleteve ekzistuese është rritur. Në hapësirën e krijuar jasht gjerësisë së urës, është pozicionuar kabina për personelin e toaleteve publike, ku edhe do të bëhet monitorimi i hyrje-daljeve. Kjo zonë përkon me sheshin e Kejtit, në të cilën frekuenca e qytetarëve në baza ditore është mjaft e lartë. Ndërsa në anën tjetër të Kejtit në vend të hyrjes së dytë (tashmë të mbyllur sipas këtij propozimi), është dizajnuar një hapësirë për pushim dhe rekreim, e cila e kompletton pjesën e Kejtit e cila poashtu shfrytëzohet më së shumti nga të rinjtë.

Me qëllim të ofrimit të çasjes nga ana e personave me aftësi të kufizuara, është propozuar ri-dizajni i rampës ekzistuese.



TOALETET PUBLIC

URA "ARASTA"


ZONE PUSHIM

Zgjidhja funksionale e toaleteve përbën plotësimin e kërkesave të dalura nga pjesëmarrësit e punëtorisë, të dimensionuara në bazë të udhëzuesve profesional për dizajnimin e toaleteve publike. Bazuar në hapësirën në dispozicion, zgjidhja funksionale tenton që të përfshijë të gjithë elemntet e përkufizuara gjatë fazës konceptuale. Këtu përfshihen: nyjet sanitare për te dy gjinitë, kabinë toaleti e çasshme nga personat me nevoja të veçanta, kthina për ndërrimin e foshnjës si dhe hapësira për gjidhënje.

Partia hyrëse është konceptuar të jetë vazhdimësi e hapësirës publike të Kejtit. Në këtë hapësirë është paraparë të jetë një vend për ulje i cili do të shërbnete për pritje apo qëndrim të lirë në hapësirë publike të Kejtit. Në këtë zonë zë vend edhe kabina e kontrollimit të hyrje-daljeve, e cila është konceptuar të shërbejë si hapësirë pune për punonjësin mbikqyrës të toaleteve publike. Kjo hapësirë njëherit shërben për ruajtjen e materialit shpenzues higjienik. Në ndarje të zonës hyrëse dhe hapësirës e cila u dedikohet decidivisht toaleteve publike, është paraparë të jetë grupacioni i lavamanëve, i cili është dimensionuar në bazë të normativave (2 guaca +1). Këtë zonë e vijon ndarja e kabinave në bazë të gjinive, ku në bazë të normativave të dizajnit të toaleteve publike, paraprinë kabina për djem dhe burra. Në këtë hapësirë është paraparë edhe vendosja e një pisoari, edhe pse kabina është individuale. Kjo për arsye se në mungesë të sipërfaqes për vendosjen e një grupacioni të pisoareve, është kërkuar që megjithatë të vendoset një pisoar si variant alternativ kur nuk shfrytëzohet guaca, varësisht nga predispozitat e shfrytëzuesit. Në vijim të kthinave është përcaktuar të jetë kabina për gra dhe vajza, e përcjellur nga kthina multi-funksionale e cila do të shërbej për ndërrimin e foshnjeve dhe për nënat të cilat kanë nevojë të kryejn procesin e gjidhënjes. Hapësira e dedikuar për toalete publike përfundon me kabinën për persona me aftësi të kufizuara, e cila është e dimensionuar për shfrytëzim nga ana e tyre, pa patur nevojë për përcjellje nga persona të dytë. Gjerësia e derës mundëson çasjen e tyre të pa problem, ndërsa hapësira e mjaftueshme për rrotullim e personit me karrocë invalide mundëson manovrimet e nevojshme për shfrytëzim optimal nga ana e këtij grupi të komunitetit.

Të gjitha hapësirat funksionale të kësaj zgjidhjeje të toaletit publik i lidh korridori lidhës, i cili është dimensionuar të jetë i çasshëm për të gjitha kategoritë e personave të cilët mund të frekuentojnë toaletet publike. Ai është dizajnuar të jetë një-vijorë në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për personat me pengesa në të parë, dhe i gjerësisë 110 cm në mënyrë që të jetë e mundshme levizja e personave me aftësi të kufizuara fizike, praktikisht nga të invaliduarit në karrocë.

Në këndin e kundërt të hyrjes, nga ana tjetër e Kejtit, janë paraparë hapësira për ulje të cilat poashtu integrohen me hapësirat përcjellëse të Kejtit.



HYRJA E TOALETEVE PUBLIKE ËSHTË  
THEKSUAR NË PEISAZHIN EKZISTUES  
URBAN NË MËNYRË QË TË JETË  
LEHTË E VËREJTSHME NGA  
SHFRYTËZUESIT POTENCIAL






KABINA KONTROLLUESE

ZONA E LAVAMANËVE

TOALET PËR M

TOALET PËR F



HAPËSIRË SHUMËFUNKSIONALE

TOALET PËR PAK

ZONË PUSHIMI


009

47

150

195

Toalet per PNV







Logo of the European Union and text: "The EU's financial assistance under the ERDF is managed by the Regional Development Fund Office."




PARTIA HYRËSE THEKSON NJËSITË FUNKSIONALE PËRBËRËSE TË HAPËSIRËS SË TOALETEVE PUBLIKE. NË KËTË ZONË ËSHTË KONCEPTUAR HAPËSIRA PËR PRITJE SI DHE KABINA E KONTROLLIMIT TË HYRJE-DALJEVE, E CILA SHËRBEN EDHE SI HAPËSIRË PUNE PËR MBIKQYRËSIN E TOALETEVE






WC PUBLIKE





NË VEND TË PIKËS SË DYTË HYRËSE ËSHTË KONCEPTUAR HAPËSIRA PËR QËNDRIM, E CILA ËSHTË VAZHDIMËSI E HAPËSIRAVE PËR ULJE NË KEJ. NË KËTË ZONË JANË THEKSUAR SIMBOLET E NJËSIVE FUNKSIONALE TË TOALETEVE PUBLIKE, PËR TË INFORMUAR TURISTËT DHE KALIMTARËT LIDHUR ME SHËRBIMET E OFRUARA NË KËNDIN TJËTËR. HAPËSIRA ËSHTË NDIÇUAR DHE OFRON SHFRYTËZIM TË SIGURT.





wc publike



VIZIONIMI PËR RI-DIZAJNIMIN E TOALETEVE PUBLIKE PËRFSHINË: NYJET SANITARE PËR TE DY GJINITË, KABINËN E DEDIKUAR PËR SHFRYTËZIM NGA PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, KTHINËN PËR NDËRRIMIN E FOSHNJES SI DHE HAPËSIRËN PËR GJIDHËNJE. KËTO DY TË FUNDIT JANË INTEGRUAR NË NJË KTHINË TË VETME. TË GJITHA HAPËSIRAT JANË PROPOZUAR TË JENË MIRË TË NDRIÇUARA DHE ME MATERIALE QË OFROJNË MUNDËSI MIRËMBAJTJEJE TË LEHTË.










NDËR HAPËSIRAT FUNKSIONALE MË TË RËNDËSISHME NË KUADËR TË TOALETEVE PUBLIKE TË SHQYRTUARA NË KËTË VIZIONIM ËSHTË HAPËSIRA SHUMËFUNKSIONALE E CILA I DEDIKOHET NËNAVE PËR GJIDHËNJE DHE PRINDËRVE PËR PASTRIMIN E FOSNJAVE.

I GJITHË DIZAJNI I TOALETEVE PUBLIKE ËSHTË PËRCAKTUAR TË JETË I THJESHTË, LEHTË I MIRËMBAJTUR DHE ME MATERIALE TË QËNDRUESHME.





EC Ma Ndryshe  
dhjetor 2017